



Hapja e Vitit Gjyqësor të Kosovës Prishtinë, 16 tetor 2015

**Fjalim nga z. Gianni Buquicchio
Kryetar i Komisionit të Venecias**

Znj. Presidente e Republikës,
Z. Kryeministër,
Znj. Kryetare e Gjykatës Kushtetuese,
Z. Kryetar i Gjykatës Supreme,
Z. Ministër i Drejtësisë,
Shkëlqesi,
Të nderuar kryetarë dhe gjyqtarë,
Zonja dhe zotërinj,

Do të doja të shpreh kënaqësinë time që jam këtu me ju sot për të festuar hapjen e Vitit Gjyqësor. Jam veçanërisht i kënaqur që jam në Kosovë, pasi që ajo tani është Shteti Anëtar më i ri i Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës.

Kosova nuk është vetëm anëtare e fundit e Komisionit të Venecias; ajo është gjithashtu një shtet shumë i ri. Ajo po bën hapa të mëdhenj jo vetëm në drejtim të njohjes së saj të plotë ndërkombëtare, por edhe në rrugën për konsolidimin e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit, të cilat janë parimet themelore të Këshillit të Evropës.

Kosova ende nuk është anëtare e Këshillit pan-evropian të Evropës. Megjithatë, vetëm një vit më parë, Kosova është bërë anëtare e plotë e Komisionit Evropian të Këshillit për Demokraci përmes Ligjit, zakonisht i quajtur Komisioni i Venecias.

Në kuadër të Këshillit të Evropës, lidhja ndërmjet Komisionit të Venecias dhe vendit tuaj është e veçantë.

Që prej anëtarësimit, Komisioni i Venecias nuk është më i detyruar që t'i referohet vendit tuaj me fusnotën e famshme “yll”, duke iu referuar Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244, e cila duhet t'i shtohet sistematikisht nga organet tjera të Këshillit të Evropës.

Zonja Presidente,

Ju lutem më lejoni të shfrytëzoj këtë rast që ta prezantojë shkurtimisht Komisionin tonë, anëtarësinë e tij, funksionimin e tij dhe t'i përcaktojme mundësitë për bashkëpunim të frytshëm.

Anëtarësimi i Komisionit të Venecias është më i madh se ai i Këshillit të Evropës, Komisioni i Venecias ka 60 Shtete Anëtare.

Megjithatë, Komisioni është pjesë integrale e Këshillit të Evropës dhe anëtarësimi në Komisionin e Venecias ndonjëherë shihet si një hap i rëndësishëm në rrugën drejt anëtarësimit në Këshillin e Evropës.

Çfarë është përbërja e Komisionit?

Komisioni i Venecias ka dy nivele të anëtarësisë, së pari Shtetet të cilat janë pranuar me vendimet e Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës.

Shtresën e dytë të anëtarësisë e përbëjnë anëtarët individualë, të emëruar nga qeveritë për një mandat katër vjeçar.

Anëtarët individualë takohen katër herë në vit në Venecia, e cila është selia e Komisionit, duke pasur parasysh se Italia ishte ajo që bëri propozimin për themelimin e Komisionit menjëherë pas rënies së murit të Berlinit.

Sipas Statutit të Komisionit, qeveritë caktojnë ekspertë të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese dhe shkencave politike.

Në praktikë, shumica e anëtarëve janë gjyqtarë të gjykatave kushtetuese - siç është rasti me anëtarët e Kosovës, ish-Kryetarin Hasani dhe Kryetaren Rama - apo profesorë të së drejtës.

Ajo që është më e rëndësishme është se anëtarët nuk përfaqësojnë Shtetin që i ka emëruar ata. Ata gjithmonë veprojnë në cilësinë e tyre individuale si ekspertë të pavarur. Në të vërtetë, anëtarët e marrin pavarësinë e tyre shumë seriozisht. Një anëtar i cili do të mbronte vendosmërisht qëndrimin e Qeverisë së tij ose të saj shumë shpejt do të humbte çdo kredibilitet brenda Komisionit.

Kush mund të kërkojë mendime nga Komisioni i Venecias?

Komisioni është në shërbim të Shteteve Anëtare të saj të cilat janë të lira të kërkojnë mendime për projekt-ndryshimet kushtetuese dhe projektligjet për zbatimin e kushtetutës.

Komisioni jep mendime për legjislacionin zgjedhor, ligjet për Gjykatën Kushtetuese, ligjet për gjyqësorin, ligjet për Avokatin e Popullit, ligjet për funksionimin dhe financimin e partive politike ose të legjislacionit për të drejtat e veçanta të njeriut siç është liria e asociimit ose liria e tubimit.

Kërkesat për mendime mund të bëhen nga autoritetet shtetërore, Presidenti i Republikës, Parlamenti, Qeveria dhe institucionet tjera shtetërore. Organet e Këshillit të Evropës dhe të organizatave ndërkombëtare gjithashtu mund të kërkojnë mendime.

Zonja Presidente,

Anëtarësimi i Kosovës në Komisionin e Venecias nuk ishte i lehtë dhe ka pasur disa qeveri që nuk e kanë mbështetur këtë hap.

Një nga argumentet që ato e kanë përdorur ka qenë se Kosova edhe ashtu mund të përfitonte nga mendimet e Komisionit të Venecias, në të kaluarën përmes kërkesave nga UNMIK-u, tash nga EULEX-i, dhe se madje nuk ishte e nevojshme që Kosova të bëhej anëtare e Komisionit të Venecias.

Megjithatë, vendet që mbështetën anëtarësimin insistonin se ishte e rëndësishme që autoritetet e Shtetit të Kosovës të ishin në gjendje për të bërë vetë kërkesa të tilla dhe të mos vareshin nga ndihma e autoriteteve ndërkombëtare. Prandaj, anëtarësimi ishte i domosdoshëm. Unë jam i lumtur që anëtarësimi është arritur dhe ne me të vërtetë presim që t'i pranojmë kërkesat për mendime nga autoritetet tuaja shtetërore.

Këto kërkesa do të jenë dëshmi se Kosova *jo vetëm që kërkon anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, në mënyrë që të konsolidojë statusin e saj ndërkombëtar*, por se ajo i merr seriozisht angazhimet dhe mundësitë që vijnë nga një anëtarësim i tillë.

Sigurisht që edhe Gjykata Kushtetuese, nikoqirja jonë sot, mund të kërkojë mendimet *amicus curiae*, lidhur me rastet e rëndësishme që janë në pritje në Gjykatë. Ndonjëherë gjykatat kushtetuese kërkojnë mendime lidhur me projektligjet që rregullojnë punën e tyre.

Duke pasur parasysh se anëtarët e Komisionit të Venecias në Kosovë janë gjyqtarë të Gjykatës, ne gjithashtu presim kërkesa nga vetë Gjykata Kushtetuese.

Si funksionon Komisioni i Venecias?

Çelësi për suksesin e punës së Komisionit të Venecias është dialogu. Brenda Komisionit, çdo anëtar është natyrisht një ekspert në sistemin e tij ose të saj kushtetues dhe ne bëjmë një dialog konstruktiv.

Ne mësojmë nga njëri-tjetri për përparësitë dhe mangësitë e marrëveshjeve të veçanta kombëtare dhe diskutojmë se si ato mund të rregullohen në mënyrë që t'i përshtaten një konteksti tjetër.

Dialogu është esencial edhe me palët e interesuara në vendin për të cilin punon Komisioni i Venecias.

Kur përgatitet një mendim, Komisioni i Venecias gjithmonë krijon një grup të vogël punues të anëtarëve të saj, të cilët i quajmë raportues.

Kur është e mundur, raportuesit udhëtojnë në vendin ku ata takohen dhe shkëmbejnë me autoritetet përkatëse - me përfaqësues nga Qeveria, nga Parlamenti, nga Gjyqësori - por edhe me opozitën dhe shoqërinë civile.

Këto takime i japin raportuesve njohuri të vlefshme jo vetëm për diskutimin kombëtar mbi çështjet e shqyrtuara, por ato gjithashtu tregojnë cilat rrugë janë në dispozicion për kompromis dhe konsensus.

Më lejoni vetëm të theksoj se anëtarët nga vendi në fjalë nuk bëhen kurrë raportues për vendin e tyre. Ky rregull siguron që ata të mos bien nën presion për të ndikuar në një mendim për vendin e tyre.

Praktikisht të gjitha mendimet janë të miratuara me konsensus, por përsëri, anëtari nga vendi në fjalë nuk mund të parandalojë një konsensus të tillë që duhet të arrihet.

Cilat janë standardet, të cilat i zbaton Komisioni i Venecias?

Së pari, më duhet të theksoj se mendimet e Komisionit të Venecias nuk janë të detyrueshme, Komisioni bën vetëm rekomandime.

Sigurisht, ne përpiqemi të përdorim argumente, të cilat kanë të ngjarë të bindin partnerët tanë; ne gjithmonë shpresojmë se rekomandimet tona pranohen dhe zbatohen, por ne nuk mund ta detyrojmë vendin përkatës që ta bëjë këtë.

Është e vërtetë se nganjëherë aktorët politikë si Bashkimi Evropian do t'i bëjnë thirrje një shteti për të ndjekur një rekomandim, që Komisioni i Venecias e ka bërë, por kjo

është pjesë e diplomacisë dhe politikës ndërkombëtare dhe mbetet jashtë fushëveprimit të Komisionit, i cili është vetëm juridik.

Rekomandimet e Komisionit të Venecias bazohen në një gamë të gjerë të burimeve.

Sigurisht, që është Konventa detyruese Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe interpretimi i saj nga ana e Gjykatës së Strasburgut, por Komisioni i Venecias do t'i referohet ligjit të butë siç janë rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.

Në fusha të caktuara, Komisioni i Venecias ka identifikuar vetë standardet, për shembull në kodet e saj të njohura gjerësisht të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore apo për partitë politike. Në disa fusha, Komisioni ka përcaktuar standardet së bashku me OSBE/ODIHR, për shembull në fushën e lirisë së tubimit ose lirisë së asociimit.

Megjithatë, Komisioni i Venecias i referohet edhe parimeve themelore të së drejtës kushtetuese, siç janë kontrolla dhe ekuilibri dhe shpesh thjesht arsyes së shëndoshë.

E rëndësishme është të shihet se Komisioni i Venecias i pranon zgjedhjet e bëra në vend, për shembull për një sistem presidencial apo parlamentar dhe pastaj vetëm bën thirrje për futjen e masave mbrojtëse për t'i bërë këto zgjedhje themelore të zbatueshme.

Zonja dhe zotërinj,

Ne jemi mbledhur këtu për hapjen e Vitit Gjyqësor.

Çfarë bën Komisioni i Venecias për të mbështetur pavarësinë e Gjyqësorit?

Komisioni i Venecias punon si në nivelin kushtetues ashtu edhe në atë legjislativ në fushën e Gjyqësorit.

Sa herë që ai përgatit një mendim për një projekt-kushtetutë apo projekt-amendamente kushtetuese, Komisioni do të rekomandojë krijimin e një Gjykate Kushtetuese të pavarur me kompetenca të fuqishme dhe qasje efektive nga ana e individëve.

Shqetësimet qendrore të Komisionit të Venecias janë edhe pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit të rregullt. Këtu, çështje kryesore janë emërimi i gjyqtarëve, karriera e tyre dhe natyrisht disiplina gjyqësore.

Në një numër të vendeve me të cilat ne punojmë, korrupsioni në gjyqësor është një problem serioz dhe ne vlerësojmë se lufta kundër korrupsionit është thelbësore për mbijetesën e demokracisë së vërtetë.

Me partnerët tanë, ne përpiqemi të hartojmë sisteme të cilat ndihmojnë mbrojtjen e gjyqësorit nga ndikimet politike duke bërë të mundur një luftë efektive kundër korrupsionit në vend.

Së fundi, Komisioni i Venecias mbështet në mënyrë aktive gjykatat kushtetuese në shtetet e saj anëtare.

Sipas themeluesit të gjykatave kushtetuese, profesorit austriak Kelsen: “Një Kushtetutë e cila nuk do të krijonte një gjykatë kushtetuese me kompetencë që të anulojë aktet antikushtetuese, është një dritë e cila nuk shkëlqen.”

Gjykatat Kushtetuese janë një gur themeli për demokracinë, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit.

Komisioni i Venecias këmbëngul në pavarësinë institucionale, administrative dhe sidomos financiare të gjykatave kushtetuese.

Gjykatat Kushtetuese vendosin për çështje delikate. Është në natyrën e funksionit të tyre kushtetues që vendimet e tyre ndonjëherë të mos pëlqehen nga Qeveria apo Parlamenti.

Sidomos në demokracitë e reja, është esenciale që ato të mos mund të “ndëshkohen” nga këto autoritete për aktgjykime të padëshiruara.

Zonja Presidente,

Më lejoni të përfundoj se Komisioni i Venecias është i gatshëm të punojë ngushtë me Kosovën, me të gjitha institucionet e saj shtetërore, Presidentin, Parlamentin, Qeverinë dhe, natyrisht, Gjykatën Kushtetuese.

Komisioni është në dispozicion që të punojë me Kosovën në të gjitha fushat e kompetencave të saj, të drejtën kushtetuese në kuptimin e ngushtë, por edhe në ligjin zgjedhor, në fushën e të drejtave të njeriut dhe natyrisht në pavarësinë e Gjyqësorit.

I gëzohem një bashkëpunimi të frytshëm me Kosovën.

Ju faleminderit shumë për vëmendjen tuaj.